



Nr. 23/1 prot  
Shkollën 14/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 18 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT  
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "TAMARA" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit "TAMARA" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i:**

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "TAMARA"sh.p.k., me administrator Z.Gerian KUKA, për përdorim të burimit ujor **Lumi i Cemit**, për prodhim energjie elektrike (HEC BROJE), në Tamarë, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.  
2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyt e mëposhtme:

-Në Lumin e Cemit jetojnë dy specie të troftës (trofta e malit dhe trofta e Cemit) të përfshira në listën e kuqe me një status VU (i përkeqësuar). Ndërtimi i hidrocentralit do të shkatëronte dhe izolonte lëvizjen e lirë të specjeve ujore në këtë lumë.

-Shkatërron mjedisin dhe turizmin

-Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve.

-Ndikim negativ në zhvillimin e lojrave të kanotazhit.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**

**Raimonda GURI**



**KRYETAR**

**Çesk MILLJA**

